

SHEKULLI.com.al

Gazeta më e madhe në Shqipëri - Botues, Koço Kokëdhima

SHEKULLI HOME

Punësime Auto Prona Udhëtime Shes/Blej biznes Arkivi

Ne Web Ne faqe Kërko

Komente

Letrat e lexuesve

Kontakt

Blog

Politikë

Presidenti

Biznes

Sport

Kulturë

Metropol

Kronikë

Edukimi

Bota e rajoni

Shëndeti

Reportazh

Shoqëri

Dossier

Arti i të jetuarit

Krah qytetarit

Më ka ndodhur

Vështrim nga larg

Komente e kritika

Komente RTV

Pro e kundër

Njoh një njeri

Mund të më thoni

Politika Blog

Kultura Blog

Shoqëria Blog

Biznesi Blog

Teknologjia Blog

Sport Blog

ZBAVITJE

Moti

Horoskopi

Sudoku

Shahu

Fjalëkryqi

SHEKULLI TREG

Punësime

Prona

Auto

Shes/Blej Biznes

Udhëtime

Shekulli TV

Shekulli Podcast

Shekulli Foto

Shekulli RSS/XML

Vlorë, zbulohen dy anije të mbytura në Luftën e Parë Botërore

Anila Peçi
01-10-2007

E-mail Print

Komentet Komenti juaj + -

Anijet u mbytën në 1915, pas takimit me një minë, vendosur nga gjermanët në ngushticën pranë Karaburunit dhe Sazanit

"Re Umberto" u dallua në 50 m thellësi dhe "Intrepido" në 30 m. Në të parën, vdiqën 60 persona dhe 5 në tjetrën

Vlorë- Pas 92 vitesh nga data e zhdukjes së tyre, janë zbuluar në Gjirin e Vlorës dy anije italiane, të mbytura në Luftën e Parë Botërore. Ka qenë Drejtori i Departamentit të Arkeologjisë Nënujore dhe Detare të Institutit Kombëtar të Arkeologjisë në Tiranë, Dr. Adrian Anastasi si dhe Presidenti i Shoqërisë Ndërkombëtare të Zhytësve Profesionistë (IANTD), të cilët kanë dhënë dje lajmin për këtë gjetje të rëndësishme arkeologjike. Dy anijet "Re Umberto", që transportonte Trupa Ushtarake dhe Anija Luftarake, "Intrepido" të mbytura në datën 4 dhjetor të vitit 1915, janë dalluar dhe filmuar dje. E para në thellësinë 50 metër dhe tjetra në 30 metër.

Mbytja e anijeve

Në bazë të të dhënave historike, pjesa që prej ishullit të Sazanit dhe deri në afërsi të Vlorës, pranë Zvrëncit ishte minuar, forcat e ushtrisë italiane kishin lënë të hapur vetëm ngushticën mes Karaburunit dhe Sazanit. Nëndetësja gjermane, C14 kishte bërë minimin e zonës me mina nënujore, të cilat ishin vendosur në ngushticën e lënë për të kaluar mjetet ujore italiane. Pre e një mine ka qenë anija 'Re Umberto', e cila si pasojë e goditjes me minën rreth orës 10.00 të mëngjesit të datës 4 dhjetor të vitit 1915, është ndarë në dy pjesë, pozicion në të cilën është gjetur dhe dje. Sipas ekipit arkeologjik, në të janë mbytur rreth 60 persona. Pas marrjes së sinjalit për mbytjen e anijes, nga Italia është nisur anija tjetër luftarake 'Intrepido', e cila ka takuar në të njëjtin minim dhe është mbytur rreth orës 17.00. Sipas arkeologëve, në këtë anije janë mbytur 5 marinarë.

Historia

Më pas nëndetësja gjermane është larguar nga vendi ku qëndronte. Ndërkohë që referuar dokumenteve historike është mbytur pas rreth 3 vjetësh, në Belgjikë si pasojë e një defekti të brendshëm. Sipas ekipit që u mor me studimin, kanë qenë të dhënate mbledhura në mënyrë të saktë si dhe studimi i anijeve me përpikmëri, të cilat kanë sjellë zbulimin dhe do të nxjerrin në dritë të dhëna shumë të sakta në lidhje me kohën, shkakun, personat që janë mbytur në të, si dhe një sërë faktesh të reja. Në pamjet e marra prej operatorit italian, duken pjesët e anijeve të mbytura, ku në disa pjesë dallohen dhe struktura, pjesët dhe disa detaje të anijes. Anija 'Re Umberto' është gjetur në thellësinë 50 metra, ndërsa anija tjetër, 'Intrepido' në thellësinë 30 metra. Sipas Dr. Adrian Anastasit, vazhdimi i kërkimeve në këtë fushë do të bëjë të mundur krijimin e një harte mbi vendndodhjen e anijeve të mbytura përgjatë dy lufrave.

Lokalizimi

Anijet fillimisht janë lokalizuar prej Cesare Balzi, instruktori i Agjencisë Didaktike IANTD, të cilat janë nxjerrë në bazë të të dhënave të sakta historiko-shkencore. Gjithçka erdhi pas një marrëveshjeje bashkëpunimi Italo-Shqiptar me temë "Kërkimi dhe Identifikimi i mbetjeve të anijeve të epokës bashkëkohore dhe moderne, me qëllim vlerësimin kulturor, turistik dhe nën ujor të bregdetit shqiptar". Marrëveshje e cila është firmosur prej Departamentit Arkeologjik Nënujor dhe Detar të institutit të Arkeologjisë në Tiranë dhe të Shoqërisë IANTD, me bazë në Marina di Pisa, në Itali. Projekti është drejtuar prej Dr. Adrian Anastasit, i caktuar nga instituti i Arkeologjisë për palën shqiptare si dhe instruktur dhe trajnues Cesare Balzi.

Ekspedita



Foto nenujore te anijeve te gjetura

SHEKULLI PDF

Shekulli PDF

FOTO DITE



Tatimet, çmime fikse për 4 mijë artikuj

SHEKULLI TV



Madhi - Pronat

BLOG

BE përballë Kosovës

Urdhra sekuestrimi për ? Albtelem?-in

Tepricat akuzojnë më shumë se Mungesat

Harta e Greqisë deri në Vlorë!!!

Liria e Presidentit



KOMENTE BLOG

xhela ferizi ne: A duhen justifikuar ata, qe mohojne kombesine e shtetesine shqiptare?

Princi-Ks ne: Harta e Greqisë deri në Vlorë!!!

gjovalin perdoj ne: Harta e Greqisë deri në Vlorë!!!

glen ne: A duhen justifikuar ata, qe mohojne kombesine e shtetesine shqiptare?

FERDEROVA DAUTI ne: Djali i Berishës, drejtor te Çalik

SONDAZHI

A do te ketë ndryshim statusi i Kosovës brënda vitit 2007?

Po Jo Voto

BIZNESI ONLINE

Dollari është rritur ndaj euros (\$)

Ekspedita për evidentimin e anijeve të mbytura ka nisur që prej 4 ditësh, ndërkohë që dy ditët e fundit janë filmuar dhe fotografuar pjesët e të dy anijeve të mbytura. Sipas një prej përfaqësuesve të Shoqatës së Zhytësve, 'Ekspedita Blu', që kryen Mbështetjen Logjistike, Genci Kapllani "Gjiri i Vlorës fshih relike të shumta të anijeve italiane me një rëndësi të veçantë historike, të cilat janë fundosurgjatë Luftës së parë dhe të dytë Botërore dhe lokalizimi dhe identifikimi i tyre merr rëndësi shkencore për të dyja vendet". Sipas Anastasit, zbulimi i këtyre veprave do të jetë një pasuri nënujore me vlera të mëdha për vetë qytetin e Vlorës.

 E-mail  Print

Posto në:  digg.it  Yahoo  Google  Slashdot  del.icio.us  Technorati

Lajme të ngjashëm

Aksidenti, 35- vjeçari bie ballkoni i nga katit...

Motra tenton të vrasë me lopatë vëllanë dhe nusen...

Fier, 30 vjeçari i paidentifikuar hidhet nga kati...

Për motive sigurie është shtuar edhe imazhi i konfirmimit të komentit. Duhet që në kutinë përkatëse të shkruani imazhin që shikoni poshtë saj, nëse një gjë e tillë nuk bëhet komenti nuk do të shtohet. Gjithashtu nga redaksia komentet më të mira botohen ne gazetë. Faleminderit për mirëkuptimin

Emri juaj:

E-mail juaj:

Titulli:

Komenti juaj:

